



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30 mars 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1714_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47, Nenin 48, dhe Nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 27 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për përcaktimin të ngarkesave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes;
- Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes;
- Vendimin V_1706_2023 të datës 23 mars 2023 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Propozimin e OSSH-së për aprovimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 27 mars 2023,

në seancën e mbajtur më 30 mars 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN** - Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH), që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- II. Struktura e tarifave për SHSSH që zbatohet nga OSSH janë dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:**

Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.14
10 kV	€/kWh	1.77
0.4 kV	€/kWh	2.84

III. Ky Vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nga data 01 prill 2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë më datë 26 maj 2022 ka iniciuar Procesin e Shqyrtimit të Tretë Periodik për operatorët e rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 11 janar 2023 ka iniciuar Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). ZRRE sipas njoftimit ka theksuar se, në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, ka analizuar të dhënat aktuale të operatorëve dhe bazuar në ato ka konstatuar se është arritur pragu i materialitetit i përcaktuar me Rregullat për të Hyrat për operatorët e rregulluar, përkatësisht janë plotësuar kushtet për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ku shkaktarët kryesor për tejkalimin e pragut të materialitetit janë bazuar në mungesën e të hyrave të realizuara dhe të kostove më të larta të energjisë me shumicë krahasuar me ato të parashikuara.
- Për shkak se implementimi i procesit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm do të ishte i njëjtë me atë të përshtatjes së rregullt vjetore, ZRRE ashtu siç përcaktohet në Rregullën e të Hyrave të OSSH-së ka marr parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në këtë shqyrtim periodik.
- ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i Shqyrtimit të Tretë Periodik për tarifën shumëvjeçare (PRR3) ka për qëllim për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të Licencuarve OST/OT dhe OSSH, respektivisht tarifën për periudhën 1 prill 2023 deri shqyrtimin e ardhshëm periodik.
- ZRRE me datë 22 nëntor 2022 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), ka pranuar aplikacionin për Hyrave të Lejuara Maksimale për PRR3 2023-2027.
- ZRRE pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM/MAR) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS sh.a), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.
- ZRRE më datë 16 shkurt 2023 ka publikuar Raportin Konsultativ për të hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH për PRR3.
- Raporti konsultativ ka paraqitur propozimet e ZRRE-së për HLM që do të mbulohen nga OSSH-së gjatë Periudhës së Tretë Rregullative PRR3. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifën për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të cilat do të ju ngarkohen shfrytëzuesve të Sistemit të Shpërndarjes. Raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.
- ZRRE gjatë konsultimit publik ka pranuar komente nga palë të ndryshme të interesit ndaj Raportit Konsultativ lidhur me HLM të PRR3, dhe atë nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sindikata

e pavarur Elektrokosova KEDS, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.


- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka dorëzuar komentet me datë 03 mars 2023, ndaj Raportit Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike në kuadër të PRR3.
 - ZRRE ka trajtuar komentet e OSSH dhe pas analizimit dhe vlerësimit profesional ka paraqitur përgjigjet me shkrim të cilat i ka përfshirë në Raportin Përfundimtar.
 - ZRRE po ashtu i ka analizuar edhe komentet e Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, ku pas analizimit dhe vlerësimit profesional ka paraqitur përgjigjet me shkrim të cilat i ka përfshirë në Raportin Përfundimtar.
 - Raporti përfundimtar i të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH-së, përfshinë vlerësimet përfundimtare dhe përgjigjet në komente të palëve të interesit.
 - Bordi i ZRRE-së, me datë 23 mars 2023 përmes Vendimit V_1706_2023 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për periudhën 01 prill 2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
 - Bordi i ZRRE-së me datë 23 mars 2023 përmes Vendimit V_1706_2023 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) KEDS SH.A., për Periudhën e Tretë Rregullative PRR3 (2023-2027), ku për vitin 2023 janë në vlerë prej 133,807,287 €.
 - Sipas Vendimit V_1706_2023, OSSH duhet t'i përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes.
 - ZRRE më datë 27 mars 2023 nga OSSH ka pranuar propozimin për Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes.
 - ZRRE ka vlerësuar propozimin për tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarje dhe ka ardhur në përfundim se tarifat i reflektojnë drejt kostot e arsyeshme për ofrimin e shërbimeve përkatëse.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarje, duke u bazuar në vendimin V_1706_2023 për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH dhe Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, ka vlerësuar se janë kalkuluar tarifat e SHSSH-së, për kostot e shërbimit për vitin relevant tarifor 2023, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.